



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 163 Prot.

Tiranë, më 15.02.2022

V E N D I M
Nr. 21, datë 15.02.2022

“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe të Metodologjisë “Për përcaktimin e afatit si pjesë e dispozitivit udhërues të vendimit paralajmërues të Komisionerit për rivendosjen e ligjshmërisë”, miratuar me Vendimin Nr.951, datë 29.12.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënieve në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për të kryer këtë detyrë, është kërkuar nga njësitë përgjegjëse në institucionet e përfshira në këtë proces, që të raportojnë në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, ende vazhdojnë marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si institucion i cili punëson nëpunës civilë. Pas kërkesës së Komisionerit për

informacion, nëpërmjet shkresës nr. 3666/1 prot., datë 17.05.2021, institucioni ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Për aparatën e ministrisë, nga analiza e informacionit të administruar pranë Komisionerit, konstatohet se, ky kusht plotësohet nga punonjësja ***** (datëlindja 26.05.1959), në pozicionin e punës “Specialiste, Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Naftës, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 26.11.2020.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në përmbajtjen e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, si edhe afati dhe organi që konstaton rrethanat, si më poshtë:

“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

- a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarin e vdekjes së tij;
- b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- c) plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë;
- ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga:

- a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;
- b) DAP-i për anëtarët e TND-së.”

Në këto kushte, plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, në rrethanat e çështjes që po shqyrtohet, është një prej rasteve që parashikohet në pikën 1/c, të kësaj dispozite dhe, për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësit ushtrjnë aktualisht detyrën, sipas pikës 2/a, të nenit të cituar më sipër, duhet të veprojë menjëherë duke e konstatuar këtë fakt, në një afat që në ligj është parashikuar 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij, si dhe duke i njoftuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpunësit civil *****.

Pozicioni i punës i cili do të mbetet i lirë pas këtij veprimi, duhet të shpallet vakant, për t’u plotësuar, sipas procedurës dhe kërkesave të neneve 21, 22, 23 etj., të ligjit në fjalë.

Për këto arsye:

Për të gjitha sa analizuar më sipër, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pikës 9, të nenit 16 të rregullores “Mbi procedurat e

mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, si dhe të Metodologjisë “*Për përcaktimin e afatit si pjesë e dispozitivit udhërues të vendimit paralojmëruës të Komisionerit për rivendosjen e ligjshmërisë*”, miratuar me Vendimin Nr.951, datë 29.12.2020, të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësin e mëposhtme:
 - ***** (datëlindja 26.05.1959), në pozicionin e punës “*Specialiste, Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Naftës, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë*”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 26.11.2020;
2. Pozicioni respektiv i punës, të raportohet pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicion i lirë.
3. Departamenti i Administratës Publike të vijojë procesin për plotësimin e këtij pozicioni sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
4. Kryerja e veprimeve të mësipërme duhet të bëhet brenda **30** ditëve nga marrja dijoni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dërgojë aktet administrative të cilat vërtetojnë realizimin e detyrave.
6. Në rast të mosrespektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Të njoftohet për këtë vendim, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,

të njoftojë punonjësit për të cilët është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për vendimin e Komisionerit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha